



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik

01 Nr.60/03-27605/23
Kaçanik 23.10.2023

FTESË PËR MBLEDHJE

Të nderuar anëtarë të Komitetit për Komunitete, me datën 27.10.2023 (e premte),do të mbahet mbledhja e VIII (të) e rregullt e Komitetit për Komunitete, për vitin 2023.

Mbledhja do të mbahet në katin e dytë të objektit të komunës në sallën e Komiteteve, më fillim pune në ora 13:00.

Mbledhjen do ta kryeson dhe udhëheq, Ekrem Livoreka, Kryesues i Komitetit për Komunitete.

Në mbledhjen e VIII (tetë) të Komitetit për Komunitete, të datës 27.10.2023, do të shqyrtohet ky:

REND PUNE

- 1.Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Komitetit për Komunitete;
- 2.Gjendja e bizneseve në komunën e Kaçanikut ;
- 3.Të ndryshme.

Ju mirëpresim,

Me respekt!

Kryesues i Komitetit për Komunitete
Ekrem Livoreka



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik
Municipal Kačanik

01Nr. 60/01- 25007/23
Kaçanik, 25.09.2023

PROCESVERBAL

Nga mbledhja **VII (shtatë)** e Rregullt e Komitetit për Komunitete, mbajtur me datë: 25 shtator 2023 (e hënë). Mbledhja u mbajt në katin e dytë të objektit të administratës Komunale, në sallën e komiteteve të Kuvendit, me fillim pune në ora 14:00.

Pjesëmarrës të këtij takimi nga Komiteti për Komunitete ishin: Lejla Muhaxheri-Çaka-PDK, Arta Avdiu-LVV, Ekrem Livoreka-AAK, Betim Shala-LDK, Arben Thaqi- OJQ. Nga Ekzekutivi i komunës në takim mori pjesë Xhelal Gashi – Drejtor QPS.

Mbledhjen e udhëhoqi, kryesuesi i Komitetit për Komunitete, Ekrem Livoreka. Procesmbajtëse Mavije Murseli, Asistente e Kryesuesit të Kuvendit.

z.Ekrem Livoreka: Fillimisht përshëndes të pranishmit, konstatoj kuorumin dhe hapi mbledhjen e VII-të (shtatë) të rregullt të Komitetit për Komunitete për vitin 2023, data 24 shkurt, me këtë :

REND PUNE

- 1.Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Komitetit për Komunitete;
- 2.Rastet sociale në komunën e Kaçanikut; dhe
3. Të ndryshme.

Nëse ka diçka rreth rendit të punës, e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë rendi i punës u shtrua në votim dhe u votua njëzëri.Në sajë të kësaj del konstatimi së Komiteti për Komunitete.

APROVOJ

Rendin e punës, në përbërje prej 3 pikave

U kalua në shqyrtimin e pikave sipas renditjes:

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e fundit e Komitetit për Komunitete

Kryesues i Komitetit Ekrem Livoreka: A keni ndonjë vërejtje rreth procesverbalit nga mbledhja e kaluar? Nëse jo atëherë, a jeni për miratimin e këtij procesverbalit ?

Procesverbalin e mbledhjes së VI (gjashtë) të Komitetit për Komunitete i vitit 2023, u aprovua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi se Komiteti për Komunitete e,

Aprovoj

Procesverbalin e mbledhjes së VI (gjashtë) të Komitetit për Komunitete të vitit 2023, të datës 27.06.2023 / Lënda : 01Nr. 60/01-14892/23.

2.Rastet sociale në komunën e Kaçanikut;

z. Xhelal Gashi : Në radhë të parë është një trend i zvogëlimit i cili në fakt nuk është real, por më shumë është formal për shkak se gjendja nuk është përmisuar, janë edhe disa kritere që janë duke u zbatuar por për mendimin tim nuk jam i pajtimit me to. Nuk është qëllimi as i imi por as i askujt që me fut dikën në skemë sociale .

Është një trend i zvogëlimit të rasteve sociale mirëpo ky është trend artificial ne jetën e përditshme pasi që kërkesat janë ato që kanë qenë, gjendja është ajo që ka qenë ndoshta edhe më e rënduar andaj kjo është një tendencë ma tepër e prerjes së rasteve sidomos e një kategorie që ka të bëjë me komisionin mjekësor. Në këto raste komisioni mjekësor po e shohin të arsyeshme me ja refuzua, realisht ka raste shumë të rënda dhe shpesh ne si punëtorë ndihemi shumë keq , numri përafërsisht sillet te numri 600 ma herët ka qene mbi 800 , nëse ne i marrim numrat me i shikua munden me than qenka përmisuar gjendja shumë por realisht nuk qëndron kjo, më shumë është pjesë e kësaj politike që po dëshirojnë me reduktua numrin.

Për komunën Kaçanikut gjithë e dimë që është komunë me specifika të veçanta dhe me gjendje ekonomike më të varfër në raport me komunat e tjera por edhe nëse e shohim anën tjetër vërehet që inflacioni ka godit Kosovën dhe krejt botën mirëpo kjo vlerë e ndihmës sociale është shumë e vogël që donë të thotë edhe atyre që ja jep nuk ju kryen punë aq sa duhet , çka bën një familje me një vlerë 100 euro unë jam shumë i pakënaqur se kemi raste që e refuzojnë por gjendja faktike është gjendje keqe pas refuzimit komisionit mjekësor ne nuk kemi drejtë . Te shërbimi social është një tendencë e rritjes të dhunës në familje ndoshta edhe për shkak të pandemisë edhe ndoshta asaj që njerëzit kanë ndjetë vetëm mbyllur tani jemi kompletua me personel te shërbimi i social. Shërbimet janë duke u kryer me rregull mirëpo ajo çka na brengos kjo dukuri e rritjes na shqetëson nuk është problemi veç me shkua e me i evidentua rastet edhe me i udhëzua se çka duhet me bë por problemi është pse po ndodhin ato.

z. Arben Thaqi : Sa është bashkëpunimi mes qeveris dhe juve për këto raste edhe pse është fond i qeveris dhe a keni bërë kërkesë për me shtu numrin e tyre tu e pa gjendjen në teren Kaçanik edhe qeveria duhet me u marr me juve dhe duhet me pa vlerësimin për qatë gjendje që keni bërë ju faktike që ka qenë.

z.Xhelal Gashi : Në të kaluarën, qendrat për punë sociale kanë qenë në Ministri por tani kanë kaluar në komunë.

E gjithë puna jonë në aspektin e raportimit ndërlidhet me qeveri ndërsa ne si komunë kemi vetëm shërbimin e mallrave, por në aspektin profesional me raporte me data baza i kemi prapë me ministri. Pengesa e dytë është se qeveria i ka shujtë ministrit, njëri shërbim ka shkua në Ministrin e Financave dhe njëri mund të kalojë në Ministrin e Drejtësisë prandaj normalisht që krijohet një vakum. Kur ka qenë ministria ne kemi pas mundësi me shkua te ministri dhe mi adresua shqetësimet e tona, realisht tani ne nuk kemi një adresë konkrete.

Ne si qendër për punë sociale konkretisht unë gjithmonë i kam udhëzuar palët e pakënaqura të vazhdojnë iniciojnë procesin e ankesës.

Ju lutem çdo raste që vëreni dhe mendoni që ju ka cënua një e drejtë lirisht të inicioni ankesë mirëpo asnjëherë asnjë ankesë nuk ka marrur rezultat pozitiv përveç një rastit .

z. Ekrem Livoreka : Te kompletimi i stafit tek zyra e pensionistëve, a kanë sjell ndonjë zyrtar sepse për aq sa kam njohuri ka ardhur një zyrtar nga komuna e Hanit të Elezit.

z. Xhelal Gashi : Nuk kanë të bëjnë me qendrën për punë sociale, por si njoftim atje është e njëjta gjendje d.m.th. ashtu janë lenë.

3.Të ndryshme:

Kryesues i Komitetit Ekrem Livoreka: A keni diçka për të diskutuar në pikën të ndryshme ? Nëse jo, atëherë e shpalli mbledhjen të përfunduar, në ora 14:45.

**Procesmbajtësja
Mavije Murseli**

**Kryesues i Komitetit për Komunitete
Ekrem Livoreka**
